



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:236724
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05523277

Ac.nr.826/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtarin individual Adnan Konushevc, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit të përmbartimit E.J nga Gj.. Rruga “H.B”, nr.7, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E.H.H, avokate nga Gjilani, kundër debitorit N.SH. “Ç...”, me seli në Gj....., të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, me seli në Prishtinë, që menaxhohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), e përfaqësuar nga Njomza Morina juriste, me objekt të çështjes përmbartim i aktgjykimit, më lartësi të objektit të kërkesës për kamatën ligjore prej 4.5 % të shumës 2.096,08 euro, si dhe shumën prej 745.92 euro, në emër të kontributeve të detyrueshme për financimin e kursimeve pensionale, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur, kundër aktvendimit CP.nr.508/21 datë 28.12.2021, të Gjykatës Themelore në Gjilan, me datën -27.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e debitorit NSH “Ç...”, me seli në Gjilan, që menaxhohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, CP.nr.508/21 datë 28.12.2021, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktvendimin e atakuar CP.nr.508/21 të datës 28.12.2021, në pikën -1-, të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e të datës 05.11.2021 të debitorit NSH “Ç...”, të paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor CP.nr.508/21 të datës 25.10.2021 të Gjykatës Themelore në Gjilan dhe i njëjti urdhër mbete në fuqi. Ndërsa në pikën –II-, të dispozitivit ka detyruar debitorin NSH “Ç...”, me seli në Gjilan që kreditorit E.J, t'i paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 343.00 euro.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e debitorit e

ushtruar ndaj aktvendimit të atakuar, ashtu që të anulohet aktvendimi i ankimuar, dhe të vihen jashtë fuqie të gjitha veprimet e ndërmarra përmbaremore ose lënda të kthehet në rivendosje

Përgjigje në ankesë ka parashtruar e autorizuar e kreditorit, duke propozuar që të refuzohet ankesa e debitorit dhe të vërtetohet vendimi i atakuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 19, 194 dhe 208 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e bazuar për këto arsye:

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori i përmbaremit, përmes të autorizuarës se tij, ka paraqitur propozim për përmbare kundër debitorit, N.SH. “Ç...”, me seli në Gjilan, që është nën menaxhimin e AKP-së, ashtu që Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin CP. 508/21 i datës 28.12.2021, ka lejuar ekzekutimin në bazë të dokumentit përmbare-aktgjykimit C.nr. ... deri C.nr..., C.nr... dhe C.nr..., të datës .., të Gjykatës Themelore në Gjilan, i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm nga datë 02.05.2006, për kompensimin e të ardhurave personale dhe shpenzimet e procedurës. Kundër aktvendimit për përmbare debitori ka ushtruar prapësim.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të shkresave të lëndës dhe prapësimit vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata ka theksuar se Gjykata, përmes Aktgjykimit të dt. 11.04.2006, me të cilën është lejuar përmbaremi, vërtetoi se i njëjti aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm nga dt. 02.05.2006, për borxhin që debitori e ka ndaj kreditorit për pagesën e kamatës ligjore prej 4.5 % të shumës 2,096.08 euro si dhe shumën prej 745.92 euro, në emër të kontributeve të detyrueshme për financimin e kursimeve pensionale e cila i është njohur në bazë të vendimit gjyqësor. Kundër aktvendimit për përmbare debitori ka ushtruar prapësim me datën 05.11.2021 ndërsa kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me datën 11.12.2021. Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të shkresave të lëndës dhe prapësimit vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Ndërsa, Gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit, duke u bazuar në nenin 17 lidhur me nenin 452.1 të LPK-së, pasi që kreditori e ka fituar çështjen dhe për këtë arsye të njëjtit i'u njohën shpenzimet e procedurës në shumë prej 343.00 euro, edhe atë shumën prej 156.00 euro për propozim për përmbare, shumën prej 31.00 euro, për taksë gjyqësore, shumën prej 156.00 euro, për përgjigje në prapësim, pasi që këto shpenzime u krijuan pa vullnetin e kreditorit. Për bazë juridike i është referuar nenin 5, 22, 71, 73 si dhe neni 17 të LPP-së.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit sa i për këtë parashkrim të kërkesës së kreditorit, lidhur me dokumentin përmbartimor, pasi që propozimi për përmbartim është parashtruar në bazë të dokumentit përmbartimor – aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjiilan C.nr... të datës 11.04.2006, i cili është i plotfuqishëm nga data ..., dhe i njëjti i plotëson kushtet ligjore të parapara me nenin 22 dhe 27 të LPP-së, andaj dhe ka vendosur që ta refuzojë prapësimin pasi që nuk ka gjetur prova për vendosje ndryshe, pasi që nuk ka parashkrim të kërkesës së kreditorit, siç pretendon debitori në prapësim.

Gjykata e Apelit, nuk mund ta përkrah qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, rreth mënyrës së vendosjes sipas aktvendimit të ankimuar, në këtë rast, rrjedh se me aktgjykim C.nr.225/2006 të datës 11.04.2006, i cili është i plotfuqishëm nga data 02.05.2006 debitori është obliguar që kreditorit t'ia kompensoj të ardhurat personale në lartësi prej 2.096,08 euro me kamatë ligjore prej 4.5% ne vit, si dhe të paguaj shumën prej 745,92 euro në emër të kontributeve të detyrueshëm për financimin e kursimeve pensionale. Ndërsa me datën 26.04.2021 sipas këtij aktgjykimi kreditori është kompensuar nga debitori në shumë prej 2,223.42 euro. Megjithatë me aktvendim e atakuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk janë dhënë arsye se pse është kompensuar kreditori për 127.00 euro, me shumë se sa ka qenë shuma e gjykuar me aktgjykim. Gjithashtu lidhur me kërkesën për lartësinë prej 745.92 euro në emër të trustit pensional nuk ka prova shkresore nëse të njëjtat janë apo nuk janë paguar sipas vendimit të AKP-së të datës 06.06.2013, ndaj të cilit vendim sipas shkresave të lëndës kreditori nuk ka ushtruar ankesë.

Me nenin 10 paragrafi 1, i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034, për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përcaktohet që: *“Çdo veprim gjyqësor, administrativ apo i arbitrazhit, procedurë apo akt që përfshin apo është kundër një ndërmarrje (apo asetëve të saj), që është subjekt i Vendimit për Likuidim pezullohet pas parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim nga ana Autoritetit të Likuidimit, në gjykatën përkatëse, autoritetin publik apo tribunalin e arbitrazhit. Ky njoftim i referohet këtij neni dhe shoqërohet me një kopje të Vendimit për Likuidim dhe një kopje e të Njoftimit të publikuar për likuidim”.*

Me Udhëzuesin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 27.02.2023, në pikën -I- është përcaktuar që: *“Nga data e parashtrimit të Njoftimit të Vendimit për Likuidim, e deri në përfundimin e likuidimit, PEZULLOHET çdo procedurë gjyqësore, administrative apo e arbitrazhit që është kundër ndërmarrjes dhe asetëve të saj që është subjekt i Vendimit për Likuidim, përfshirë edhe procedurat përmbartimore të vendimeve të formës së prerë lidhur me*

kërkesat monetare”. Me të cilin udhëzim Gjykata Supreme e Konfirmon qëndrimin e marr nga Udhëzuesi Juridik i Dhomës së Posaqme C-IV-15-1607 të datës 15.10.2015.

Gjykata e Apelit vlerëson se në këtë rast, para se të vendoset lidhur me prapësimin e debitorit, është dashur që të plotësohen kushtet ligjore, për këto arsye kjo gjykatë me vlerësimin dhe analizimin e tërësishëm të shkresave të lëndës ka gjetur se aktvendimi i ankimuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës përmbartimore. Tutje, Gjykata ankimore gjen se për kundër faktit se debitori N.SH. “Ç...”, me seli në Gjilan, e ka njoftuar gjykatën se gjendet në procedurë të likuidimit, megjithatë gjykata se ka ndërmarr asnjë veprim procedural lidhur me njoftimin për likuidim.

Mbi bazën e shkeljeve të konstatuara si më lartë, kjo gjykatë gjeti se aktvendimi i ankimuar duhet prishur dhe çështja duhet kthyer në rivendosje tek gjykata e shkallës së parë, pasi që në rastin konkret nuk ka pasur kushte që i njëjti aktvendim të mund të ndryshohet nga ana e gjykatës së shkallës së dytë.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që t’i ketë parasysh shkeljet e cekura si më lartë dhe që për evitimin e tyre lidhur çështjen në fjalë, të ndërmerr veprime përkatëse përmes të cilave do ta sqaroj faktin nëse debitori gjendet ende në likuidim, a ka përfunduar procedura e likuidimit apo në raport me kreditorin eventualisht a është zhvilluar ndonjë procedurë nga autoriteti i likuidatorit lidhur me aktgjykimin lëndor, krejt këto më qëllim që gjykata pastaj duke aplikuar dispozitat ligjore, të ketë mundësi që të bie një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj. Në çdo rast veprimet dhe vendimet e gjykatës duhet të jenë në harmoni me dispozitat ligjore dhe standardet e gjykimit të drejtë.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *”Në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209, pika d) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77, të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.826/22 datë 27.03.2024

G j y q t a r i
Adnan Konushevci